



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

**BASHKIA DURRËS
DREJTORIA E TAKSAVE DHE TARIFAVE VENDORE**

Nr. _____ prot.

Durrës, më ____ . ____ . 2026

NJOFTIM PËR TAKSAPAGUESIT

Në zbatim të **Ligjit nr. 86/2025 “Për fshirjen, shuarjen dhe pagesën e detyrimeve tatimore ndaj administratës tatimore qendrore e vendore dhe detyrimeve të pagueshme në doganë”** ju njoftojmë se pas shqyrtimit nga **Komisioni Bashkiak i ngritur me Vendimin nr. _____, datë _____ të Kryetarit të Bashkisë**, është vendosur si më poshtë:

- **Detyrimet deri më 31.12.2014:** Fshihen plotësisht.
- **Detyrimet për periudhën 2015–2019:** Mund të përfitoni nga shuarja e pjeshme/me kusht, sipas zgjedhjes suaj:
 - 50% e detyrimit fshihet, nëse paguani pjesën tjetër 50% brenda datës **30.06.2026**.
 - 25% e detyrimit fshihet, nëse paguani pjesën tjetër 75% brenda datës **31.12.2026**.
 - Në të dyja rastet, gjobot dhe kamatëvonesat fshihen plotësisht.
- **Detyrimet për periudhën 2020–2024:** Fshihen gjobot dhe kamatëvonesat, me kusht që të paguhet 100% i principalit deri më **31.12.2026**.

Afatet dhe të drejtat tuaja:

- Ky vendim ka efekt deri më **31.12.2026**.
- Nëse nuk përmbushni kushtet e pagesës brenda afateve, nuk përfitoni nga fshirja/shuarja.
- Ju keni të drejtë të ankoheni pranë gjykatës administrative, sipas legjislacionit në fuqi.

Nga fshirja/shuarja e detyrimeve të parashikuara, sipas ligjit nr. **86/2025**, nuk përfitojnë tatimpaguesit/ subjektet që kanë detyrime tatimore të cilët janë dënuar me vendim gjyqësor të formës së prerë ose janë në proces gjyqësor apo hetimi për vepra penale në fushën tatimore, në kuptim të legjislacionit të fushës, përpara ose gjatë kohëzgjatjes së zbatimit të këtij ligji.

Me respekt,

DREJTORIA E TAKSAVE DHE TARIFAVE VENDORE

